

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXI i botimit, nr. 232, Shkurt 2023
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Dukagjin dashnia jeme! Dukagjin deli zot vetit!

Dukagjin të erdhi dita / N'kam po çohen djem e çika / N'kam po çohen gra e burra / Me çdo çmim me u ba rruga.


2



PAPA KLEMENTI 4 (ALBANI) PO VJEN NË SHQIPËRI NGA ILIR BIGA

Në antologjinë Papnore, Gjon Françesk Albani shëmbëllen si dritë e pa praruar, me rendin e Papëve më të mëdhenj, që kanë drejtuar Selinë e Shenjtë.

Pati lindur më 23 korrik 1649 në Urbino të Italisë. Kreu një arsim solid, duke marrë formim të gjithanshëm kulturor, teologjik dhe filozofik. Pasi veshi veladonin e shenjte punoi me shkathësi e devocion falë talentit dhe dhuntive të veçanta ngjiti shumë shpejt shkallët e karrierës kishtarë: Së pari, në detyrën e Sekretarit të kan



Bashkëbisedim retrospektivë, me Papa Gjon Palin e Dytë

Nga Jas Gavronksi Po ribotojmë bashkëbisedimin e Papa Gjon Palit të Dytë të gazetarit të shquar polka, Jas Gavronksi mbi idetë, analizat e vizionet e tij për Luftën e Paqen, Bashkimin Evropian, Kapitalizmin, Komunizmin, Rrugën e Tretë si alternativë e zhvillimit të Shoqërisë Njerëzore e të tjera. Shpresoj, që ky bashkëbisedim të konsiderohet i dobishëm dhe me interes, edhe tani pas afër një çerek shekulli, veçanërisht në situatën dhe rrethanat e reja sfiduese të krijuara pas largimit të Britanisë së Madhe nga Unioni Evropian, për opinionin publik, lexuesit dhe dashamirësit e shumtë të gazetës "DUKAGJINI", në Shqipëri e kudo në Botë.

Frederik Rreshpja, Mjeshtëri i Madh

Rreshpja, liriku më i shquar i poezisë sonë, ku realja dhe surealja janë në raporte të harmonishme estetike. Frederik Rreshpja, lindur me 19 korrik 1940, në Shkodër, me origjinë nga fshati Plan, i krahinës së Pultit, zone e Dukagjinit, vdekur me 17 shkurt 2006. Ai ishte poet lirik, eseist, publicist dhe botues. Penda e tij është ndër më të suksesshet të vargut shqip.

Fisniku i Dukagjinit, Tomë Zef Fusha

Kush ishte Tomë Zef Fusha?

Tomë Zef Fusha, lindi më 13 prill 1942, në fshatin Ndreaj, të krahinës së Shoshit, i biri i Zefit e Shkurtes dhe u nda nga jeta më 5 tetor 2007.

Tomë Zefi lindi në kullën e Bajraktarit të Shoshit, djali i dytë i rrallës së Zef Deli Marashit. Tomë Zefi ishte stërnipi i Marash Kolës, i cili ka marrë pjesë në Lidhjen e Prizrenit, dhe nipi i Deli Marashit, i cili i priu Shoshit në luftën kundër Dergut Pashës në Qafë të Agrit. Ku asht edhe kënga e vjetër:

"Dergut Pasha merr dylbit / Qafës Agrit ja lshon sytë / Kenka mbush Bjeshka d'almni / Deli Marashi tuj pri."

Dita Botërore e Gjuhës Amtare



Dita Botërore e Gjuhës së Nënës (Amtare) është data 21 shkurt 2022.

- GËZUAR FESTËN E GJUHËS AMTARE SHQIPE! GJUHA SHQIPE E VJETËR VLERË BOTËRORE- E CILA DUHET TË JETË VLERË E UNESCO-s, PËR KËTO ARSYE:

1. Gjuha jonë, është në 3-4 gjuhët më të vjetra në botë.
2. Gjuha Shqipe, është pasardhëse e gjuhës pellazgo-Ilire
3. Gjuha Shqipe, është folur nga Homeri dhe përdorur edhe te Iliada.
4. Gjuha Shqipe ka pasur përhapje të madhe gjeografike ndërkontinentale.

Gjuha është një mjet komunikimi e shprehës

5

Dukagjin dashnia jeme! Dukagjin deli zot vetit!

Dukagjin të erdhi dita

N'kam po çohen djem e çika

N'kam po çohen gra e burra

Me çdo çmim me u ba rruga.

Ngjarja më e rëndësishme në 30 vite për zonën e Dukagjinit. Mbështetje maksimale në çdo formë të mundshme. "Unë jam gati, t' gjithë jemi gati, me 20 Shkurt është dita e Dukagjinit. I lumtur që erdhi kjo ditë, i lumtur që dukagjinasi po behën bashkë, për të mirën e vendlindjes tonë të shtrenjte!"

NJOFTIMI TELEVIZIV: RRUGA E DUKAGJINIT

Mijëra jetë njerëzish ende sot e kësaj dite janë në rrezik! Rruga e Dukagjinit tash 30 vite në Mëshirë të fatit, ku dhjetëra gra e burra humben jetën në aksidente rrugore dhe mbi 200 të tjerë të plagosur e gjymtuar.

Qeveria duhet të vendosë dhe t'i japë një zgjidhje përfundimtare Rrugës së Dukagjinit.

Rruga e Dukagjinit hap perspektiven e zhvillimit të një zonë me potencial të veçanta natyror, kulturore dhe historike, mundësi e madhe kjo për banoret e Dukagjinit dhe Shkodrës.

"Në e duam Rrugën e Dukagjinit!", e duam në gjurmën ekzistuese, në atë gjurmë që lidhë 30 fshatrat ndër me piktoresket në Evropë.

Kjo ishte thirrja e mbi dy mijë protestuesve kryesisht banorë të Dukagjinit, që u bashkuan me 20 Shkurt 2023, pa dallime politike. Në një protestën paqësore para institucioneve të Bashkisë dhe Prefekturës Shkodër, për të kërkuar "RRUGËN E DUKAGJINIT".

Protesta filloi me një minutë heshtje dhe mbas një marshimi në qendër të qytetit u mbyll përball shtatores së Shenjtores Nanë Tereza, me ndezje qirinsh dhe nën lutjen "JEPJAU ZOT PUSHIMIN E PASOSUN!" për shpirtat e viktimave të aksidental e humbur jetën në rrugën e Dukagjinit.

Protesta u shoqërua me thirrje dhe parulla të shumta për rrugën Prekal-Kire-Shosh-Shalë, u valëvit Flamuri Kombëtarë dhe u dha deklarata për mediat si vijon:

KOMUNIKATË PËR SHTYP

Rruga e Dukagjinit!

Të dashur qytetarë të Shkodrës!

Të nderuar prijës fetar; autoritete civile dhe ushtarake që ndodheni në mesin tonë, shpresojmë, të zhveshur nga petkat e përkatësisë politike!

Të nderuara media të ndryshme kombëtare dhe lokale!

Sot, në këtë manifestim të harmonizuar në mënyrë vëllazërore dhe me integritet të pastër shpirtëror dhe mendimesh, pa asnjë lloj ngjyrimi politik, nuk jemi mbledhur për të paraqitur resurset e shumta natyrore që ofron krahina e Dukagjinit, as për të bërë konferenca shkencore me natyrë informuese për antropologjinë kulturore dhe për dimensionet e ndryshme etnografike dhe etnologjike.

Sot jemi mbledhur për të kërkuar nga strukturat e qeverisë qendrore dhe lokale që të marrin masat e nevojshme për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës së Dukagjinit.



Gjendja e rrugës



Komisioni i organizimit e drejtimit të protestës

Dëshirojmë t'ju shprehim mirënjohjen tonë për pjesëmarrjen tuaj në mbështetje të këtij manifestimi paqësor, dhe të paraqesim objektivat e protestës sonë të ngritur mbi liritë dhe drejtat kushtetuese, qofshin ato natyrore apo juridike,

të sanksionuara në kushtetutën e vendit si dhe në konventa dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare ku ne aderojmë. Dhe konkretisht duhet të nënvizojmë këtu të drejtat themelore kushtetuese, siç janë: e

jeve tragjike të përjetuara këto vitet e fundit për shkak të aksit rrugor që përshkon krejt zonën homonime në lindje të Shkodrës, në drejtim të alpeve, totalisht jashtë kushteve teknike të çdo rruge urbane.

Është dhimbshme ta shikosh karregjatën e mbushur plot me pllaka përkujtimore, qirinj dhe simbole të tjera që i përkasin nekrologjisë dhe jo të drejtës së jetës, si një nga pasuritë me të çmueshme të mbrojtur me ligj, dhe e nënvizuar me forcë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut,

Edhe pse thirrjet dhe kërkesat tona kanë qenë të vijueshme, qoftë me kërkesa zyrtare apo kronikave televizive, deri sot kanë qenë pa asnjë rezultat konkret.

Për këtë arsye, sot edhe në Ditën Ndërkombëtare të Drejtësisë Sociale, populli i Dukagjinit.

Kërkon:

1-Të merren masat e nevojshme për ndërtimin dhe asfaltimin segmentit rrugor që lidhe Njësitë Administrative të Pulit, Shoshit e Shalës, duke filluar nga fshati Prekal, në përputhje me normat e miratuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2-Të filloj mirëmbajtja e rrugës ekzistuese derisa të nisin punimet për Rrugën e Re.

3-Të informohemi mbi të vërtetën rreth projektit, nëse ka pasur një të tillë në 30 vitet e fundit, fondin si dhe të dhëna teknike dhe inxhinierike, që lidhen me Rrugën e Dukagjinit, bazuar në ligjin nr.119, për të Drejtën e Informimit ku theksohet se: "çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik"

Po e mbyllim këtë deklaratë duke parafrazuar fjalët e shkrimtarit Ernest Koliqi në tregimin "Përru i Dukagjinit": "Nuk e dijmë na të gjithë se përtej atyne ledheve kalaje së gjallë, ruhen e pruhentëpricat e Ilyris? Po atëherë pse nuk ngjitemi deri atje për me i a zbulue rrajët qënjës s'onë kombtare, për me i a hulumtue tharmet brumit me të cilin jemi ngjeshun?"

Me bindjen e plotë që kërkesa jonë do të merret në konsideratë dhe që së shpejti do të kemi një rezultat konkret pozitiv, shprehim mirënjohjen tonë të thellë për të gjitha institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale.

Me respekt, bashkësia Dukagjinasi!

Në përgjigje te protestës se popullit te Dukagjinit dolën me deklarata në media Bashkia Shkodër dhe deputeti i Shkodrës Benët Beci. Në të dyja deklaratat u përshëndet protesta, si një proteste e drejte, dhe shprehen qëndrimin e tyre duke e konsideruar rrugën e Dukagjinit si një segment me prioritet të jashtëzakonshëm për zhvillim.

Kjo proteste filloi si një nisme e ndërmarr nga rinia e Dukagjinit, që përmes rrjeteve social bënë thirrje për protestë. Në kohë rekord thirrja u përfaqfu nga shoqata, biznese, intelektual dhe individë përfaqësues të zonës se Dukagjinit.

drejta e jetës, e drejta e lëvizjes, e drejta e përfaqësimit, e drejta përfitimit të shërbi-meve të barabarta, e të tjera.

Rruga e Dukagjinit, siç është etiketuar kohët e fundit nga mediat: Rruga e "Frikës", është shkaktare e shumë ngjar-



Grupi organizativ “Dukagjini kërkon Rrugën”

Koordinatorët teknik:

1. Mark Rupa
2. Prele Milani
3. Gjin Markaj
4. Luigj Mila

Koordinator Juridik

1. Anton Kosteri

Koordinatorët për mediat e shkruara dhe vizive:

1. Roza Pjetri
2. Klod Zhivani
3. Kozeta Bruçi
4. Terenc Pepa

Koordinatorët për Biznesin

1. Gjon Martin Gila
2. Ndue Ftoni
3. Gjergj Ndreke Luca

Koordinatorët për shoqërinë civile

1. Ndue Sanaj
2. Lulash Brigja

Koordinatorët për diasporën:

1. Dede Prendaj
2. Gjergj Temeli

Koordinator për mediat sociale:

Dukagjin Deli Zot Vetit

Grupi drejtues i tubimit

1. Zef Sokoli
2. Ndue Sanaj
3. Gjon Vojvoda
4. Gege Zef Fusha
5. Leke Zogu



6. Nikolle Avdia
7. Luigj Mila
8. Pal Shkambi
9. Agim Dardha,
10. Agron Hasanaj
11. Ndoc Ashta
12. Pal Zef Pjetri
13. Fran Kodra
14. Fran Sukani
15. Lin Zorgji
16. Mark Prroni
17. Kole Kodrari
18. Tonin Mani
19. Kole Sukullari
20. Gjon Rrasari
21. Ndue Fiku
22. Fran Marashi
23. Lulash Deda
24. Mirash Zefi
25. Pal Raka

Falënderimet janë të shumta:
Falënderojmë Zotin dhe i lutemi që kjo Kauzë të vazhdojë me sukses!

Falënderojmë të gjithë organizatorët dhe pjesëmarrësit për mbështetjen dhe kulturën që manifestuan! Falënderojmë të gjithë miqtë e dashamirët të Dukagjinit, që morën pjesë dhe na mbështetën më mesazhet e tyre anë e mbanë botës!

Falënderojmë të gjitha mediat e shkruara dhe vizive, që vite ma radhë duke sakrifikuar edhe jetën, kanë qenë zëri i vetëm për Rrugën e Dukagjinit!

I falënderojmë që në kohë rekord dhe pa shpërblim, transmetuan Siglën e protestës, protestën dhe ftesat e organizatorëve në emisione të ndryshme të tyre.

GRUPI KOORDINATOR

PAPA KLEMENTI (ALBANI) PO VJEN NË SHQIPËRI NGA ILIR BIGA

Në antologjinë Papnore, Gjon Françesk Albani shëmbëllen si dritë e pa praruar, me rendin e Papëve më të mëdhenj, që kanë drejtuar Selinë e Shenjtë.

Pati lindur më 23 korrik 1649 në Urbino të Italisë. Kreu një arsim solid, duke marrë formim të gjithanshëm kulturor, teologjik dhe filozofik. Pasi veshi veladonin e shenjte punoi me shkathtësi e devocion falë talentit dhe dhuntive të veçanta ngjiti shumë shpejt shkallët e karrierës kishtarë: Së pari, në detyrën e Sekretarit të kanonikëve (1687), më pas në detyrën e Kardinalit (1690) dhe më pas 23 nëntor 1700), ngjitet në maje të fronit Papnor, duke u bërë 261-ti, pasardhës i Shën Pjetrit, Udhëheqësi suprem i Vatikanit. Megjithatë, pati një shtegtim të vështirë mes stuhish të dalldisura nga konflikti i vazhdueshëm ndërmjet Francës e Perandorisë spanjolle, që polli rrezikun e një sulmi të armatosur kundër papatit. Urata përballoi me urtësi këtë konflikt e të tjera, që u krijuan pas Traktateve të Utrehtit, të Ratsadit e të Badenit (1712- 1714), që u caktuan normat për ndarjen e Evropës. Më pas iu desh të përballonte një rrezik tjetër: atë të pushtimit turk. Papa Klementi XI- Albani, përmendet dhe njihet për "origjinën e tij shqiptare, ndoshta nga ky shkak që një motiv plus për ndihmesën në mbajtjen e [Kuvendi të Arbërit](#), me 1703, ndonëse se ka pasur edhe plot merita të tjera për çështjen shqiptare. Ndjenja e fortë e origjinës Shqiptare e Papës Klementi XI -Albani u shfaq edhe në çastin kur u zgjodh Pape. Mbas emrit Papnor, ai vendosi dhe mbiemrin e vet Albani, për tu dalluar përpara botes, se është shqiptar, gjë që defakto rrezon ndonjë zë mohues të këtij fakti.

Papa, me origjinë shqiptare, Klementi XI luftoi me mish e me shpirt për të bashkuar Krishterimin, dha rezultate të gjëra në Shqipëri ku [Kisha katolike romake](#) dhe ajo ortodokse bashkëjetuan për

një periudhë.

PAPA KLEMETI DHE KUVENDI I ARBRIT, 1703

Klementi XI, u interesua shumë për rilindjen politike dhe fetare të atdheut të vet. I përket asaj periudhe mbajtja e "Këshillit fetar të parë kombëtar shqiptar" (1703), i cili shënoi ndryshimet rrënjësore në linjën e veprimit të klerit për çështjet dogmatike, morale, kanunore dhe ipeshkvnore. Në vitin 1701, Papa Klementi themeloi për shqiptarët e Italisë një kolegji në San Dimitria Korone.

Në shekullin XVII arbërorët përjetonin një përhapje të jashtëzakonshme të Islamit, i cili në Arbërinë e mesme dhe atë veriore kishte arrite në përmasën e 50% të popullatës, që kishin braktisë besimin katolik e duke kaluar në besimin islam. Procesi i rrënimt dhe tkurrjes së katolicizmit, në Gegëri, (fjala është edhe për Maqedoninë e sotme) si rrjedhojë e përparimit të procesit të islamizimit dhe ortodoksisë sllave, manifestohej gjithashtu edhe në pakësimin e numrit të dioqezave dhe të famullive, sidomos në kryedioqezën e Tivarit dhe atë të Shkupit. Në këtë drejtim, relacionet e Imzot Pjeter Bogdanit, (1656-1877) nga gjysma e shekullit XVII e në vijim, flasin për braktisje masive të fesë katolike dhe përfaqim të islamit dhe ortodoksisë sllave në Kryedioqezën e Tivarit dhe të Shkupit, dhe ku në vitin 1665, në Kryedioqezën e Tivarit numëroheshin vetëm 2 400 besimtarë, ndërsa në qytetin e Tivarit nuk kishte asnjë familje katolike.¹

Shqipëria në atë periudhe vuante më tepër se askush nën thundrën e sundimit

¹ NIKË DOM UKGJINI, *Kisha Katolike në trevat shqiptare*, Qendra botuese, Shoqata e Jezuiteve, Tiranë, Enti botues, Gjergj Fishta, Lezhë, 2016, f. 113.

osman. e harruar dhe e braktisur nga Evropa, e cila dikur e shihte me simpati për luftërat që pati bërë nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, që luftoi për 25 vjet rresht për mbrojtjen e krishterimit dhe qytetërimit evropian. Në këtë rënie të lire duhej një frymëzim dhe përpjekje

it të egër osman. Kuvendi mbare arbëror u mbajt në fshatin Mërq, të Lezhës, në vitin 1703. Kuvendi në fjalë i kryesuar nga delegati papnore Vincenc Zmajeviq dhe prelatët me të lartë arbër vendosi, si një vetëmbrojtje kombëtare, midis të tjerash, që t'i jepej fund dhe dilemave për çështjen e kalimit të katolikëve në islam, kriptokatolicizimit si fenomen tashme i përhapur në gjitha trojet shqiptare dhe përdorimit sa më shumë i gjuhës shqipe nga misionaret që vepronin në Arbëri e të tjera².

PAPË KLEMETIN NË TOKËN AMË PO E SJELL ILIR BIGA!

Tashmë, që luftërat e rrepta kanë pushuar po vjen prej tyre i pa lodhur, pasi i turren varg e vijë të vjetrat mote. Papë Klementi po vjen si vezullim i një vegimi, atje ku lindi arbëror e thërret. Po vjen mes natyrës gëzimplotë, sy ëmbël e vështrim i qeshur, sheh malet që ngrenë kryet përjetë, kundërmon fushat veshur me vello të blertë.

Dr. Dom Nikë Ukgjini humluesi arkifakteve të mbuluar nga harresa e pret te shtegu me uratën: - Mirë se erdhe i bekuar atë! Radhësh i bardhë në qelën e Arbrit fole e mbroje lirie ndër kohërat më mizore. Bariu i vjetër fisnik, po vjen i veshur me veladon e bilurtë skalitur nga dora e mjeshtrit Sadik Spahiu. Fisnik dhe me përlulësi do ulet i qete atje në altarin e kishës përballë odeonit historik, ku qene mbledhur gjithë Ipeshkvijve të tokës së arbrit, 320 vjet më pare.

² P. Vincenc Malaj, *Kuvendi i Arbërit 1703*, Instituti Filozofisë dhe Sociologjisë, Prishtinë; Botimi i Dytë, "Shoqata don Gjon Buzuku", Ulqin-Tuz 1999, f.112; Konferenca Ipeshkvore Shqiptare, *Kuvendi i Arbërit, 1703*, Tiranë-Prishtinë, 2003.



Ilir Biga, te Kisha e Shem Rrokut, në fshatin Gimaj



Bashkëbisedim retrospektivë, me Papa Gjon Palin e Dytë

Nga **Jas Gavronksi**

Po ribotojmë bashkëbisedimin e Papa Gjon Palit të Dytë dhënë gazetarit të shquar polak, Jas Gavronksi mbi idetë, analizat e vizionet e tij për Luftën e Paqen, Bashkimin Evropian, Kapitalizmin, Komunizmin, Rrugën e Tretë si alternativë e zhvillimit të Shoqërisë Njerëzore e të tjera. Shpresoj, që ky bashkëbisedim të konsiderohet i dobishëm dhe me interes, edhe tani pas afër një çerek shekulli, veçanërisht në situatën dhe rrethanat e reja sfiduese të krijuara pas largimit të Britanisë së Madhe nga Unioni Evropian, për opinionin publik, lexuesit dhe dashamirësit e shumtë të gazetës "DUKAGJINI", në Shqipëri e kudo në Botë.

Jam gjithashtu i gëzuar që arrita të nxjerrë në dritë nga "Kutia e Memories" një material me vlerë të jashtëzakonshme për dje, sot dhe të ardhmen e njerëzimit: bashkëbisedimin e Papa Gjon Pali II-të dhënë gazetarit të shquar polak Jas Gavronksi, i cili filloi me nevojën urgjente të një ndërhyrje humanitare dhe ushtarake ndërkombëtare në ish Jugosllavinë e atyre viteve.

Luigi Temali

Më lejoni ta filloj me një pyetje për sa i përket një problemi urgjent ndërkombëtar, lufta në ish Jugosllavinë. Kur ju folët për një "Ndërhyrje humanitare në Ballkan", kishte nga ata që e panë këtë si tregues domethënës për një ndërhyrje ushtarake. A është kështu?

Jo nuk është kështu, çfarë unë nënkuptoja është se në raste agresioni, është imperativë ti hiqet agresorit mundësia për të vijuar më tej. Është një dallim i hollë, por sipas doktrinës tradicionale të Kishës një luftë e drejtë është vetëm ajo e vetëmbrojtjes. Çdo komb ka të drejtë të mbroj vetveten. Ky është një parim që u formua nga Shën Agostini dhe u riafirmua nga Këshilli i Vatikanit II më 1960.

Po a ka pasur evolucion në mendimet e Papës nga Kuvajti në Jugosllavi?

Unë kam ruajtur gjithnjë pozicionin tim opozitar ndaj luftës, natyrisht brenda kufijve për sa fola më sipër. Lufta është e drejtë kur bëhet vetëm për qëllime mbrojtjeje, sepse po e përsëris gjithkush e ka të drejtën e vetëmbrojtjes. Si rrjedhim nuk mund të flitet për një evolucion në mendimet e Papës në sensin që nënkuptoni. Ju e dini që në kohën e luftës së Gjirit problemi shihej në trajtë pak të ndryshme. Për mendimin tim, në fazën e dytë, lufta u bë më pak vetëmbrojtëse dhe më shumë një luftë për qëllime ndëshkimore. Për më tepër, atmosfera e përgjithshme në atë rajon ishte shumë e nderë. Kishte përpjekje për ti dhënë konfliktit ngjyra fetare. Të gjitha këto i sqaron shumë mirë pozicionin

i Selisë së Shenjtë që ka qenë gjithnjë në përputhje me parimet e sipërpërmendura dhe në sintoni me komunitetin ndërkombëtar.

Në Ballkan gjendja është ndryshe. Ne po ballafaqohemi me një problem dramatik të ngurtë. Ne po shohim në ish Jugosllavinë që rënia e komunizmit ka përkuar rizgjimin e nacionalizmave radikale, që

ashtuquajturit shkuarje të Polonisë drejt Evropës, por jam kundër përpjekjeve për ta bërë këtë përpjekje idhull. Në realitet Polonia nuk ka nevojë të hyjë në Evropë, sepse ajo është tashmë në Evropë, drejt e në qendrën e saj. Është e rëndësishme që të jetë pjesë e Evropës me vlerat e saj dhe jo duke adoptuar qorrazi traditat e Perëndimit, jo duke asimiluar të keqen e tyre.



i kanë çuar njerëzit në akte dhune edhe shkaktuan vuajtje të padëgjueshme mes njerëzve të pafajshëm. Pozicioni i Selisë së Shenjtë ka qenë gjithnjë në kërkim të ndalimit të luftërave vëllavrasëse. Që në fillim, Sllovenia, Kroacia dhe më vonë Bosnja vendosen që të mbanin referendume për pavarësinë dhe zgjodhën atë rrugë, ato ishin krejtësisht brenda të drejtave të tyre për të vepruar kështu. Por qysh në atë kohë ishte ende e mundur që të shpëtohej paqja, duke u përpjekur për të dialoguar për një zgjidhje të re, një formë konfederate. Për fat të keq ngjarjet ndodhën ndryshe dhe dolën jashtë kontrollit.

Atë i Shenjtë, sot ju jeni më popullor se asnjëherë tjetër që kur u ngjitët në fronin pontifical (papnor). Ky është një përfundim disi i pazakontë për dike që ka qenë "pushtet" për 15 vjet. Por kritikën tuaj janë ende për tu dëgjuar, madje edhe në Poloninë "tënde". Pse pikërisht në Poloni?

Është e vërtetë se sot në Poloni mbas media e disa kompleksitetëve ideologjike të caktuara janë duke u përpjekur ta paraqesin figurën e Papës në një pamje disi të errët. Gjithsesi duhet të nënvizohet strategjia e mjeteve polake të informacionit, që nuk pasqyrojnë ndjenjat e çiltëra të popullsisë katolike si një e tërë. Problemi qëndron për të kuptuar arsyet themelore për këtë orientim kritik. Dhe për mua në bazën e këtij problemi qëndron një koncept i gabuar për të kuptuar çdo të thotë të shkosh drejt Evropës. Unë arrita në këto përfundime për këtë problem gjatë udhëtimit tim të fundit në Poloni më 1991 dhe gjithashtu në disa raste të tjera. Natyrisht unë nuk jam kundër të

caktuar kapitalizmi të egër e të papërm-bajtur, të cilin të gjithë e njohin mirë. Gjithashtu duhet marrë parasysh enciklikat shoqërore dhe veçanërisht të parën Rerum Novarum 1893, në të cilën Leo XIII përshkruan kushtet e punëtorëve në atë kohë. Marksi e përshkroi atë gjithashtu në mënyrën e tij. Kjo është se si ishte realiteti shoqëror, pa dyshim dhe ishte dhe

një pasojë e sistemit, të parimeve të një kapitalizmi ultraliberal. Dhe kështu reaksioni ndaj këtij realiteti u çua edhe më përpara, u rritë dhe fitoi përkrahjen e shumë njerëzve, jo vetëm brenda klasës punëtore, por edhe në radhët e intelektualëve. Shumë prej tyre menduan se komunizmi do të mund të përmirësonte cilësinë e jetës. Në këtë mënyrë shumë intelektualë, edhe në Poloni, u dorëzuan dhe bashkëpunuan me komunizmin. Pastaj, në një pikë të caktuar, ata e kuptuan se realiteti ishte ndryshe nga si e imagjinuan. Disa prej tyre, më trimat e më të drejtë u distancuan nga pushteti dhe kaluan në opozitë.

Dhe ky kthim në pushtet i komunistëve në disa vende ish komuniste si mund të shpjegohet?

Këtu është e rëndësishme të kihet parasysh disa dallime. Nuk është edhe aq një çështje e kthimit të komunizmit sesa një kundërveprim ndaj jo efikasitetit të qeverive të reja, diçka për më tepër nuk vjen si surprizë. Klasa e vjetër në politikë që qëndroi për 50 vjet ishte ajo komuniste. Ata janë të parët që mësuan si ecën politika, si funksionon parlamenti. Dhe të tjerët, ata që sot janë caktuar "si qendër" ose si e "djathtë" nuk ishin të përgatitur të qeverisnin, sepse ata nuk kanë pasur ndonjë mundësi të mëparshme ta bënin këtë. Ata ishin të fortë dhe të bashkuar, në opozitë, në Poloni, në kohën e Solidarnostit, por tani janë ndarë. Në një farë mënyre ky është edhe një huq politik, një lloj atavizmi, një individualizëm i tepruar që çon në fragmentarizëm dhe ndarje në skenën politiko-shoqërore. Forca e tyre qëndron në opozitën dhe jo në idetë konstruktive që të çojnë në qeverisje të suksesshme.

Në Vilnius, në të njëjtin udhëtim në vendet Balltike, ju folët në lidhje me hendekun mes opozitarëve dhe komunistëve. "Le të mos ketë as fitimtarë as të mposhtur", me kusht që të mposhturit, p.sh. Komunistët të kujtojnë se ata duhet të lajnë krimet e tyre të shëmtuara dhe të japin shenja të sinqerta të një ndryshimi. Praktikisht a jeni kundër komunistëve të rinovuar?

Po unë e kam thënë atë, ata duhet të ndryshojnë dhe të bien në marrëveshje me të kaluarën. Por është diçka se jo të gjithë prej tyre dëshirojnë ta bëjnë këtë, as

Në një ese që ju shkruat shumë vite më parë "Një kufi për Evropën. Ku?", ju pohoni se kufijtë nuk shtrihen përgjatë tokës, por përgjatë qenieve njerëzore. A është ende ky një opinion i juaji?

Unë do të thosha se kjo është një çështje etike më shumë sesa statistike. P. sh. Kufijtë në tokë duhet domosdoshmërisht të kalojnë përmes parimit të dinjitetit të njeriut dhe lirisë së tij, natyrisht të kuptuara drejt. Megjithatë unë e shkrova këtë ese në një kohë kur komunizmi ekzistonte ende dhe përmbajtja e saj duhet të shpjegohet sipas kontekstit.

Cili mendoni ju ka qenë roli juaj në rënien e komunizmit që shumë njerëz, përfshi këtu edhe Les Valesen, me të cilin kam folur disa javë më parë, mendojnë se ka qenë vendimtar?

Unë mendoj se, në qoftë se ndonjë gjë kishte rol vendimtar, i tillë ishte ai i krishtianizmit me doktrinën e tij, me mesazhin e tij moral dhe fetar, me mbrojtjen e tij të qenësishme të humanizmit të njeriut dhe të të drejtave të tij. Dhe unë nuk bëra asgjë më tepër sesa të kujtoj, të përsëris e të këmbëngul se ky parim që duhet respektuar mbi të gjitha parimet e lirisë fetare, por jo vetëm ajo liri por edhe të gjitha liritë e tjera të njeriut human.

Pse komunizmi pati suksesin për të cilin ai lindi në histori dhe si e shpjegoni faktin se ai është ende një forcë për tu marrë parasysh në perëndimin, ndërsa në disa vende të tjera si Lituani, Poloni u kthye në pushtet përmes zgjedhjeve të lira?

Komunizmi ka pasur suksesin e tij këtë shekull si kundërveprim ndaj një forme të

Pushofsh në Paqe Nusja e Dukagjinit!

Mimika Luca, aktorja e madhe e skenës shqiptare, ka ndërruar jetë. Aktorja e njohur ka mbyllur sytë përgjithmonë në moshën 85 vjeç.

Mimika Luca u lind në Gjirokastrë më 24 dhjetor të vitit 1937 në një familje intelektuale. Babai e la në femërinë e hershme të saj. Nëna e rriti me dashurin për jetë dhe artin, që në moshë shumë të re interpretoi në skenën e Teatrit të Operas dhe Baletit, si balerinë. Për njëmbëdhjetë vite, nga 1951 deri në 1962. Më pas, jeta e saj mori një drejtim tjetër, atë të aktrimit. Mimika Luca u pranua në vitin 1962 aktore në Teatrin Popullor, ku ka interpretuar rreth 30 role, si Suzana, Luçia, Dila "Cuca e maleve", Sonja, Nica "Gjenerali i ushtrisë së vdekur", Laja "Kur hidheshin themelet" e të tjera. Ka interpretuar edhe në 12 filma artistikë. Roli i parë ka qenë krahu bashkëshortit Ndreka Luca, në film-in "Detyrë e posaçme", më pas në filmin "Kryengritje në pallat", "Kur hidheshin themelet" e shumë të tjera. Një personazh i rrallë si Mimika Luca nuk harrohet dot nga publiku shqiptar, ashtu si roli i nënës së Marigosë të "Përrallë nga e kaluara".

Rolet e nënave, të edukatoreve apo edhe të mësuesve duket se ishin të prera për karakterin e saj. Më 1984, ajo interpreton edukatoren te filmi "Taulanti kërkon një motër". Regjisorja Xhanfizo Keko e dinte që ajo ishte aktorja e vetme që mund ta mishëronte aq lehtë atë figurë.

Ajo shkroi edhe disa drama, të cilat u vunë në Teatrin Popullor, më e njohura "Drita". Në vitin 1977 fillon punë në



detyrën e pedagoges në Institutin e Lartë të Arteve, dega Dramë, por nuk ju nda filmit.

"Nëna ime nuk donte që të bëhesha as balerinë as aktore. Dontë një profesion tjetër për mua. Ama më çonte vet në Pallatin e Kulturës, që mos ta harxhoja kohën kot, edhe pse ajo nuk donte të bëhesha artiste".

Ajo ishte balerinë, 16 vjeç, kur u marros pas aktorit 10 vite më të madh në moshë. Nuk donte të dinte për asgjë, as për vitet e saj, as për fjalët e të tjerëve, e donte dhe

pikë! Zoti i bekoj me fëmijë ku përcollën dashurin për profesionin e tyre. Gjergji mori pjese në disa filma, në të cilët spikat roli i tij përkrah babait tek filmi "Flaka e maleve" Ai tashmë është një ndër biznesmenët më të aftë në Shqipëri.

Fatkeqësisht, sot ajo ka mbyllur sytë përgjithmonë për të shkuar pranë bashkëshortit të saj, aktorit të shquar Ndreka Luca, që gjithë jetën e deshi dhe vlerësoj forcë e karakterit dukagjinës, i cili përcillte virtytet të pashoqe në një kohë mjaftë të vështirë.

Një vajzë Gjirokastrë e rritur në Tiranë harmonizohet me mënyrë perfekte me Ndreken, djalin dukagjinës, i cili i dhuroj jo vetëm dashurin bashkëshortore, por edhe dashurin për artin. Ajo së bashku me Ndreken u dashura edhe më prejardhjen e tij dhe vlerësoj gjithë jetën dhe ju ushqeu edhe fëmijëve virtytet e të qenurit njeri, artis e punëtorë. Mungesën e tij e ka ndjerë me vite, por familja i ka qëndruar gjithmonë pranë. Djali i saj Gjergji, ka zgjedhur që të birin t'i vendosë emrin e Ndrekes, duke e lartësuar të atin në breza. Bashkë me të bijën Rozafa, dy fëmijët i dhanë një dimension tjetër përfytyrimit për jetën.

Mimika Luca jetoi me Gjergjin në periferi të Elbasanit, në oazin e ngritur nga i biri, ku figura e aktorëve, e të gjithë aktorëve, lartësohet siç në fakt duhet të jetë.

Në prag të 85 vjetorit, dy muaj më parë ajo i dha gazetares "Suada Daci" një intervistë të rrallë, të fundit, Ajo u shpreh: "S'kam asnjë peng. Madje gjëja më e bukur është që Gjergji i vuri emrin djalit të vogël, Ndreka Luca. I ngjet shumë...".

Dhimbja që la te familjarët, kolegët dhe ata që e njohën është e madhe, ama aktorja e mirënjohur e skenës shqiptare iku pa asnjë peng nga kjo botë.

Pushofsh në Paqe Nusja e Dukagjinit!

Roza Pjetri

Kush duhet të udhëheqë?

"Kush duhet të udhëheqë?", është pyetja themelore e filozofisë platoniane. Dhe Platoni përgjigjet: "Më i miri dhe, njëkohësisht, më i dituri".

Në shikimin e parë, duket sikur përgjigjeja është e saktë, dhe problemi është zgjidhur.

Por, si i bëhet puna, nëse më i miri dhe më i dituri, nuk e mendon veten, më i miri dhe më i dituri, dhe e refuzon udhëheqjen?

Ka ndodhur me Albert Einsteinin. Në vitin 1953, qeveria e Izraelit i ofroi postin e presidentit të vendit. Ai u përgjigj: "Faleminderit, jam disi naiv në politikë".

Kjo është ajo që pret një sokratist, nga më i miri dhe më i dituri. Një sokratist, sigurisht mendon që, ai që e mendon veten më i miri dhe më i dituri, duhet të jetë një i marrë i vërtetë.

Përsëri mbetemi tek pyetja: "Kush duhet të udhëheqë"? Ndoshta pyetja është komplet e gabuar. Megjithatë kjo pyetje shtrohet gjithmonë, dhe gjithmonë, ka të njëjtën përgjigje, ashtu si në kohën e Platonit.

Shumë kohë më parë, përgjigja ishte e tillë: "Perandori i zgjedhur nga ushtarët, ka të drejtën e ushtrimit të pushtetit, për të qëndruar në pushtet".

Më vonë, ndryshoi diçka: "Të drejtën

e udhëheqjes e ka princi i ligjshëm, nga vullneti i Zotit".

Marksit shtronte pyetjen: Kush duhet ta ketë pushtetin, pushtetin e diktaturës? Proletariati apo kapitalizmi? Përgjigja ishte: "Të mirët, klasa e vetëdijshme, proletariati. Kurrë të liqte, kapitalistët gjakpirës. Sigurisht që jo, as lumpenproletariati!" Marksit i urrente ata.

Proletariati është diktaturë. I thonë "Diktatura e Proletariatit". Udhëheqësit diktatorë, vetëm me pushkë mund t'i rrëzosh nga pushteti.

Atëherë kush!?

Shumica e teorikëve të demokracisë, përgjigjen sipas Platonit, por me një ndryshim: "Princi i legjitim nga vullneti i Zotit", duhet zëvendësuar me: "Populli me vullnetin e Zotit". Ata mendojnë se, fjalët "me vullnetin e Zotit", duhen hequr, dhe formulimi do të jetë: "Populli, me vullnetin e popullit".

Kështu thuhej në Romën e Lashtë: Vox populi vox dei (zëri i popullit, zëri i Zotit).

Kjo është vetëm teorikisht. Populli voton, por nuk zgjedh, llapë por nuk vendosë.

Përgjigja nuk është gjetur akoma. Përsëri jemi tek pyetja e Platonit: "Kush duhet të udhëheqë?" Vazhdimisht kjo pyetje luan një rol shumë të madh në teorinë

e politikës, në teorinë e legjimitetit. Dhe veçanërisht në teorinë e demokracisë.

Thuhet, që një qeveri, gëzon të drejtën e qeverisjes, nëse është legjitime, çka do të thotë kur është zgjedhur nga shumica e popullit apo përfaqësueset legjitime të tij.

Praktika na ka mësuar diçka ndryshe. Hitleri erdhi në pushtet në mënyrë legjitime, dhe ndryshimin e ligjit që e bëri atë të plotpushtetshëm, diktator, e bëri nëpërmjet parlamentit. Duket se principi i legjitimitetit të pushtetit, nuk është i mjaftueshëm.

Një pakicë diktatoriale mund të kthehet në një sundim barbar mbi shumicën.

Ndoshta duhet shtruar ndryshe pyetja: "Si mund ta ndërtojme ligjin, sipas të cilit, populli mund ta heq qafe qeverinë e gabuar, pa gjakderdhje?"

Kjo pyetje shtrën problemin, si mund ta heqim qeverinë qafe, dhe jo si mund ta zgjedhim atë.

Fjala "demokraci" që do të thotë "pushteti i popullit", mjerisht është një diçka e rrezikshme.

Çdo votues e din shumë mirë, se ai përfaqësohet, dhe nuk udhëheq, prandaj e mendon demokracinë një gjepur. Këtu fshihet rreziku.

Në shkollë mësojmë që, demokracia është mjeti më i mirë për të shmangur dhe

luftuar tiraninë, diktaturën. Ky princip na vjen që nga Greqia e lashtë. Na pëlqen të gjithëve. Kur mendojmë diktatorët dhe tiranët, mendja na punon vetëm për demokracinë. Është shumë e vështirë të rrëzosh një diktator nga pushteti pa gjakderdhje. Çdo diktaturë është e pamoralshme, çdo diktator njeh vetëm moralin e ligësisë.

Është naivitet të mendohet, se një ditë, diktatori do të tregohet i arsyeshëm, dhe do t'i dorëzojë vullnetarisht çelësat e pushtetit.

Si i bëhet për ta hequr qafe, pa gjakderdhje?

Ka një mundësi. Mjeti më i mirë janë zgjedhjet.

Me zgjedhje, nuk duhet menduar se ne të gjithë mund të qeverisim por, ne të gjithë, mund të ulim qeverinë e gabuar në bankën e të akuzuarit. Dita e zgjedhjeve duhet menduar dita e gjyqit të madh të qeverisë së gabuar, dhe jo dita e legjimitetit të qeverisë së re. Dita në të cilën qeveria duhet të japë llogari para popullit.

Duket e vështirë, por kjo është rruga e shpëtimit nga diktatura dhe diktatorët, pa gjakderdhje. Me militantë politikë, nuk bëhet kjo punë.

Me shqipfolës, të cilët mendojnë sllavo-orientalist, dhe janë gati të bashkohen me çdo armik të kombit, kundër kombit të tyre, nuk bëhet.

Lekë Imeraj
shkrimtar, përkthyes, publicist

Frederik Rreshpja, Mjeshtëri i Madh

Frederik RRESHPJA, poet (Shkrimtar), publicist “Mjeshtër i Madh”

Rreshpja, liriku më i shquar i poezisë sonë, ku realja dhe surreala janë në raporte të harmonishme estetike

Frederik Rreshpja, lindur me 19 korrik 1940, në Shkodër, me origjinë nga fshati Plan, i krahinës së Pultit, zone e Dukagjinit, vdekur me 17 shkurt 2006. Ai ishte poet lirik, eseist, publicist dhe botues. Penda e tij është ndër më përfaqësueset të vargut shqip.

Jeta

Lindi në Shkodër në një familje me origjinë nga Dukagjini, i ati Marku i Sokol Vuksanajt ishte i vëllazërisë Prendreaj nga fshati i Planit; ndërsa e ëma Drandafilja nga Xhani. Vatra familjare qe me fëmijë shumë, me motrat Antoneta, Pashka, Anunciata dhe vëllezërit Kelin e Gjovalin. Femërinë e kaloi në lagjen “Mëhalla e Çakajve”. Prania me grat e së ëmës e nxiti të mësonte edhe qepjen, në vendlindje kreu shkollimin fillor dhe të mesëm pranë gjimnazit “29 nëntori”, studimet universitare i ndoqi pranë Pedagogjikut në Tiranë, me korrespondencë. Punoi në gjendjen civile në Dajç të Bregut të Bunës, më pas nëpunës si përgjegjës kulturor pranë Kombinatit të Drurit në Shkodër.

Poezia “Topi fushor” hyn në antologjinë më të rëndësishme zyrtare të kohës pa botuar ende ndonjë përmbledhje. Më 1967 iu botua vepra e parë letrare, përmbledhja me poezi “Rapsodi shqiptare”.

Botimet dhe shkrimet ndër të përkohshmet e kohës u pritën mirë nga kritika, por kjo gjë nuk zgjati për shumë kohë.

Në vitin 1957 - Arrestohet në vitin e II Gjimnaz për agitacion e propagandë kundër pushtetit, dënohet me tre vjet burgim.

Në vitin 1959-1961 - Përgjegjës i shtëpisë së kulturës në Bajzë të Shkodrës.

Në vitin 1961-1963 - Arsimitar në Dukagjin.

Në vitin 1963 - Student në Universitetin dega gjuhë-letërsi.

Në vitin 1964 - Arrestohet sërish për agitacion e propagandë, dënohet 3 vjet burg.

Në vitin 1966 - Redaktor në gazetën “Puna”. Shëtit për një vit si gazetar në gjithë gazetat dhe përfundon në gazetën “Drita” me ndërhyrjen e I. Kadaresë. Po atë vit formon gazetën lokale të Shkodrës “Jeta e Re”.

Në vitin 1966-1968 - Punon si piktor në Fabrikën e Letrës Shkodër.

Në vitin 1968-1971 - Punon ekonomist në Ndërmarrjen e Ndërtimit.

Në vitin 1971-1974 - Me ndërhyrjen e Shuteriqit dhe miratimin e Ramiz Alisë del në profesion të lirë si shkrimtar.

Në vitin 1974-1976 - Arsimitar në Shkodër.

Në vitin 1976-1980 - Dënohet dhe kryen dënimin në Spaç për arsye politike, me motivacion: “... si një person që paraqet

rrezikshmëri shoqërore, që synon në minimum, dobësimin dhe përmbysjen e pushtetit popullor...”.

Në vitin 1981-1984 - Merret me trageti të paligjshme për kohën.

Në vitin 1984 - Arrestohet prapë; pas 1 viti hetuesi lirohet për mungesë provash.

Në vitin 1986 - Arrestohet prapë me akuzën “spionazh në shërbim të KGB-së dhe CIA-s” nëpërmjet një marinari polak. Lirohet pas 10 muajsh hetuesi për mungesë provash.

Në vitin 1988-1989 - Shtrohet në spital.

Në vitin 1989 - Arrestohet për krijimin e një partie socialdemokrate. Lirohet

se çfarë e gëzon dhe trishton më shumë në jetë, i përgjigjet: “Nuk e di nëse më ka mbetur ndonjë gjë në këtë botë, që të më gëzojë. (...) Kur trishtohem, shkruaj. Prandaj shkruaj shumë...”. “Vetmi e trishtim poetic”, ky që do theksohej në vëllimin poetik që do të vinte.

Me rënien e regjimit, me hapjen e shtypshkronjës dhe shtëpisë botuese përfshihet me botimet dhe redaktimet, nxjerr vëllimin me poezi të titulluar “Erdhi ora të vdes përsëri” më 1994 dhe “Lirika” më 1996.

Përfshihet në vëllimin “Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501 – 2001” nga

botuar në Prishtinë, më 1975;


11- Përmbledhje poetike “Erdhi ora të vdes përsëri”, më 1994”

12-Në vitin 1994 - “Trofta hutaqe”, përralla, ribotim i përpunuar.

13- Përmbledhje poetike “Lirika”, më 1996;

14-Permbledhje poetike “Në vetmi”, me 2004, me parathënie, në të cilën, në parathënie nga Shpëtim Kelmendi përmendet se çmonte De Radën, Mjeden, Lasgushin edhe Ali Asllanin.

Poeti Frederik Rreshpja, është përfshire në vëllimin “Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë 1501 – 2001” nga Hasan



në vitin 1990 para ardhjes së kryetarit të OKB-së Peres De Kuelar.

Në vitin 1991 Frederiku u bë kryeredaktori i gazetës “Ora” të Partisë Socialiste të Shkodrës. Ai qe gjithashtu kandidat për deputet nga ana e PS-së në zgjedhjet e marsit 1992. Nga fillim vitit 1992-shit shpërngulet nga Shkodra në Tiranë, ku ai ishte themelues e pronar i shtypshkronjës dhe shtëpisë botuese “Evropa” dhe drejtor i revistës kulturore - letrare me po të njëjtin emër. Pas vitit 2000 përjetoi një varfëri të skajshme dhe kalon të jetoj në Shtëpinë e të moshuarve në Shkodër. Aty pësoi një hemorragji cerebrale më 2001. Vdes më 17 shkurt të 2006 në Shkodër dhe varroset të nesërmen në varrezat e Rrëmajit.

Vepra

Mësohet se poezia e parë e shkruar prej tij i ishte kushtuar s’ëmës, Files - siç e quante. Nga Adriatik Kallulli i botohet përmbledhja poetike “Rapsodi shqiptare”, më 1967 dhe vitin tjetër “Tri përralla për fëmijë” dhe “Trimi i fshatit Bardhë”, “Eranda” më 1969. Romanin “Zëri i largët i kasolles” më 1972 dhe dramën “Ëndrra e tokës” dhe “Trofta hutaqe” më 1973, për t’iu rikthyer sërishmi poezisë me përmbledhjen “Në këtë qytet” po atë vit. Vargu i tij u kaplua me t’u parë nga antologjitë e kohës, për t’u lënë më pas në humbëtirën e persekutimit të autorit. Më 25 nëntor 1992, Rreshpja jep një intervistë për gazetën “Zëri i Rinisë” dhe pyetjes

Hasan Hasani, mbasandej në vëllimin “Historia e Letërsisë Shqiptare” e Robert Elsie-t të 2003. Përfaqësohet me disa poezi në “Anthologie de la poésie albanaise” të Aleksandër Zotos (Chambéry, 1998) dhe në “Antologjinë e poezisë shqipe - Gjysmëshekulli i artë” të Ali Aliut (Tetovë, 2000) si dhe e rrumbullakosen punimin e G. Krasniqit “Poezi. Sprovë antologjike” (Tiranë, 2003). I vendosur ndër shkallaret e arketipit të poetit shqiptar sipas kritikës, kishte komunikim direkt me entit e poezisë - gjë e cila e bënte t’i kalonte kornizat e kohës, burgut, e të tjera.

Botime:

1-Përmbledhja poetike “Rapsodi shqiptare”, më 1967;

2-Përmbledhje poetike “Tri përralla për fëmijë”, me 1968;

3- Përmbledhje poetike “Trimi i fshatit Bardhë”, me 1969;

4- Përmbledhje poetike “Eranda” më 1969;

5-Drame “Ëndrra e Gurit”, vu në skenë nga Ali Oseku, që më pas u arrestua për këtë si skenograf, më 1971;

6- Romanin “Zëri i largët i kasolles” më 1972;

7- Dramën “Ëndrra e tokës”, më 1973;

8- Dramën “Trofta hutaqe” më 1973;

9- Përmbledhje poetiken “Në këtë qytet”, më 1973;

Në vitin 1974 - I hiqet e drejta e botimit pa afat.

10-Vëllimi me poezi “Enise, Enise”,

Hasani, mbasandej në vëllimin “Historia e Letërsisë Shqiptare” e Robert Elsie-t të 2003. Përfaqësohet me disa poezi në “Anthologie de la poésie albanaise” të Aleksandër Zotos (Chambéry, 1998) dhe në “Antologjinë e poezisë shqipe - Gjysmëshekulli i artë” të Ali Aliut (Tetovë, 2000) si dhe e rrumbullakosen punimin e G. Krasniqit “Poezi. Sprovë antologjike” (Tiranë, 2003). I vendosur ndër shkallaret e arketipit të poetit shqiptar sipas kritikës, kishte komunikim direkt me etnit e poezisë - gjë e cila e bënte t’i kalonte kornizat e kohës, burgut, e të tjera.

Frederik Rreshpja është një nga poetët më të mirë të letërsisë shqipe të gjysmës së dytë të shekullit të XX. Një pjesë e veprës së tij është në dorëshkrim.

Gati për botimi (të shkruara)

- “Çeku i bardhë”, dramë;

- Një libër me përralla;

- “Ballkani i Perëndisë”, roman;


- “Çarlsi investitor në Shqipëri”, roman humoristik;

- “Vetmi”, poezi.

Me propozim të kryesisë së Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe mbështetjen e Kryetares së Bashkisë Shkodër, zonjën Voltana Ademi, Presidenti i republikës së Shqipërisë, zoti Bujar Nishani, me 27 mars 2017 i ka dekretuar dekoratën “Mjeshtër i Madhe”.

Ndue Sanaj e Lulash Brigja

Fisniku i Dukagjinit, Tomë Zef Fusha



Tomë Zef FUSHA, 13 prill 1942-5 tetor 2007

Kush ishte Tomë Zef Fusha?

Tomë Zef Fusha, lindi më 13 prill 1942, në fshatin Ndreaj, të krahinës së Shoshit, i biri i Zefit e Shkurtes dhe u nda nga jeta më 5 tetor 2007.

Tomë Zefi lindi në kullën e Bajraktarit të Shoshit, djali i dytë i rrallës së Zef Deli Marashit. Tomë Zefi ishte stërnipi i Marash Kolës, i cili ka marrë pjesë në Lidhjen e Prizrenit, dhe nipi i Deli Marashit, i cili i priu Shoshit në luftën kundër Dergut Pashës në Qafë të Agrit. Ku asht edhe kënga e vjetër:

“Dergut Pasha merr dylbit / Qafës Agrit ja lshon sytë / Kenka mbush Bjeshka djelmni / Deli Marashi tuj pri.”

Tomë Zefi ishte i biri i Zef Deli Marashit, i cili u plagos në luftën kundër komunizmit. Tomë Zefi ishte nipi i Bekë Deli Marashit, i cili u vra në luftën kundër regjimit komunist.

Toma ishte 7 vjeç, kur familja e tij u internua në Berat. Me nënën e tij Shkurte Lulja, e bija e Lulash Ndreut të Pecajve të Shalës. Tomës në internim në Berat, i vdiq edhe vëllai 3 vjeç. Tomë Zefi u rrit me shumë vështirësi ekonomike, për arsye të paraardhësve të tij, të cilët kishin dalë kundër regjimit komunist. Me këtë fatkeqësi filloi kalavara e vuajtjeve dhe persekutimit politik i krejt familjes. Toma Zefi ishte nipi i Lulash Ndreut, Ndre Markut, Mark Lules së Shalës.

Toma ishte në shkollë fillore nxënës shembullor, por biografia që kishin si familje nuk e lejuan me vazhdua shkollën. Këtu filluan vuajtjet, në moshën 20

vjeçare shkon ushtar në Korçë. Lirohet nga ushtria, dhe duke pa vështirësitë familjare detyrohet që të shkojë në punë në Cukal, për të mbajtur familjen me bukë. Puna në Cukal nuk ishte e lehtë, me pre dru me sëpatë në dy metër borë. Atje punoi shtatë vjet. Toma gjatë punës në Cukal njohu një vajzë në fshatin Malagji, në krahinën e Dushmanit, të shtëpisë së Marash Palit. I kërkoi dorën vajzës, sipas traditës dhe u fejuan.

U bë e njohur në gjithë kantierin e Cukalit, se Tomë Zefi është fejuar, me vajzën e Marash Palit te fshatit Malagji dhe për rrjedhojë organizata e Partisë e fshatit nxjerrin Marashin para përgjegjësisë, se ka fejuar vajzën me një të deklasuar..., Tomë Zef Fushën, i shtëpisë së ish Bajraktarit të krahinës së Shoshit, por Marashi e mohon dhe thotë se nuk është e vërtetë.

Toma ishte me punë në Cukal dhe në gazetën e ditës shkruhej se, u prish fejesa e vajzës së Marash Palit me djalin e shtëpisë së ish Bajraktarit të Shoshit. Toma shumë i revoltuar, por i matur për çdo veprim e do të kryente, niset nga Cukali dhe shkon në Malagji te miku Marash Pali, me gazetë në dorë dhe i thotë shihe çfarë shkruan gazeta. Miku Marash Pali i thotë: *“Skam pas rrugë tjetër, por ti mos u mërzi se vajza asht e jotja kur të duash me e marrë.”*

Toma shkon te shtëpia dhe ia tregon historinë babës së vet, Zef Delisë dhe organizohen për me marrë vajzën pa u bannuse. Vajza punon gjithë ditën ne brigadë, në Malagji dhe kur erret nata e merr e ama, Prende Zefja dhe e çon në Gurë të Lekës natën, te Vuksan Leka i Gurit të Lekës dhe aty shkojnë me marr Lulen. Shkon kushërini i Tomës, Ded Lulashi, vëllezërit Fran e Geg Zefi e marrin nusen dhe e çojnë te shpija. Nuk u bë dasme, se nuk ka guxua kush me marre pjese në dasmë. Shumë interesant, se me këtë rast Tomën e largojnë nga puna në Cukal, sikur ishte ne pune zyre!?!

Pastaj Toma shkoi me punë në Fierzë, në Rruga-Urë, që ishte puna më e vështirë dhe punoi 32 vjet për të mbajtur familjen me bukë.

Tomës i është dashtë me punua e me vuajt shumë, jo vetëm që duhej të mbante familjen, duke punuar në punë të vështira, por dhe përndjekur si person me prejardhje antiregjim të kohës, ndoshta më shumë se të tjerët, se jo vetëm ishte punëtor i palodhur, por i mençur, inteligjent dhe mjaft komunikues me njerëzit, me koleget e punës e më gjerë.

Me ardhjen e demokracisë, Tomë Zef

Fusha ishte një burrë i pa shkollë, i vuajtur, me probleme financiare, por me zemër të madhe, ishte fisnik, megjithatë shkollën e kishte fitua me zgjuarsinë e tij, me punën e tij, me eksperiencën e tij në komunikimin me njerëzit të të gjitha fushave, por që ia kishte dhanë dhe Zoti e familja.

fshatit Plan. Në këtë gjykim, ose në këtë pajtim, morën pjesë mjaft burra nga i gjithë Dukagjini, por në veçanti ishte pajtimtari Tomë Zef Fusha i fshatit Ndreaj i krahinës së Shoshit dhe Zef Sokol Vladaj i fshatit Pecaj i krahinës së Shalës..

Pajtimi i dytë është bere me datë 5 dh-



Deli Marashi, Gjyshi i Tomë Zef Fushës



Marash Kola, anëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, gjyshi i Zef Delise



Zef Deli Marashi, baba i Tomë Zef Fushës



Bashkëshortet Lula Marashi e Tom Zef Fsuha



Tom Zef FUSHA

Tomë Zef Fusha, në vitin 1990, në filimet e demokracisë, filloi me misionin “Humanizmi”, me burra të Dukagjinit për pajtimin e gjaqeve dhe ngatërresave të ndryshme.

Pajtimi i parë në Shqipëri është bërë në krahinën e Shoshit, në fshatin e Brashtës, tek shtëpia e Gjon Marashit. Aty janë vendos gjaqet krye për krye Kolë Gjon Marashi i fshatit Brashtë me Zef Tomen e

jetor 1992, natën e festës së Shënkollit, në mes Prek Gjeloshit e Ndue Gjonit, te dy prej fshatit Prekal dhe është falur gjaku në mes tyre. Në këtë pajtim kane marrë pjesë Famullitari i fshatit Prekal dhe burrat e Dukagjinit, në veçanti Tomë Zef Fusha i krahinës së Shoshit, Zef Sokol Vladaj i krahinës së Shalës, Pjeter Noshi i krahinës së Mërturit, Sokol Delia i krahinës së Nikajve, Dede Voci i fshatit të Kirit, Adem Isufi i fshatit të Urës së Shtrenjtë, Ndue Deda i fshatit të Nicaive të krahinës së Shoshit, Mhill Nika i fshatit të Planit, Kolë Toma i krahinës së Shllakut e shumë të tjerë.

Protagonisti kryesor i këtij pajtimi ishte Tomë Zef Fusha i Shoshit, se pajtimi ishte në fis të krahinës së Shoshit, në fshatin Prekal.

Toma, me ndjenja të larta të fisnikërisë, me ardhjen e demokracisë, të gjitha padrejtësitë që iu ishin bërë në kohën e regjimit komunist, familjes së tij, nuk mori hak dhe ia la të kaluarës gjithçka, duke dhanë shembullin i pari të



Grupi i pajtimtareve, në mes tyre, Tomë Zef Fusha, Zef Sokol Vladaj, Man Salihi, Ndoc Ashta, Emin Spahia e Ymer Myrtyja



Tomë Zef Fusha, duke përshëndetur pjesëmarrësit, me rastin e, dhënies së titullit “Qytetar Nderi të Shkodrës” Profesor Kolë Prelës

Në kujtim të rapsodit Gjergj Mark Suka

I motivuar për të shprehur krenarinë të jesh malësor me gen artisti, ku i mirënjohuri gjyshi im, Rapsodi Gjergj Mark Suka, për gati një shekull nuk e lëshoi lavden nga dora, duke i rënë dhe kënduar në logje, në festa e gëzime.

I vlerësuar si lahutar me za, artin e lahutës ua trashëgoi edhe djalit, Ndues dhe nipit, Dodës (babës dhe vëllait tim).

Në këtë rrugëtim brezash kam privilegjin të jem edhe baba i stërnipit të tij, lahutarit Emanuel Suka, i cili pak kohë më parë u vlerësua me titullin "Rapsodi i vogël më i mirë në trojet shqiptare", nga juria e "Festivalit Tipologjik" të zhvilluar në qytetin e Lezhës, në muajin nëntor të vitit 2022, i cili u prezantua me Lavden 99 vjeçare të Stërgjyshit të tij. Dhe jo vetëm kaq, pasi në këtë botë magjiplote të artit dhe folklorit krenaria ime sa vjen e rritet edhe nga dy vajzat e mia, të cilat dita ditës po shkëlqejnë në skena e festival, duke ba që kjo fidanishte e folklorit ta përtërijë dhe trashëgoj me dinjitet genin tonë artistik me trinjakët e mi artist Emanueli, Emanuela dhe Elizabeta Suka, të cilët që në vogëli kanë marrë dije, edukim dhe formim artistik në Shkollën e Muzikës "Prenk Jakova" në Shkodër.

Megjithatë kjo ndjenjë e madhe e krenarisë nuk ishte motivi kryesor, që më nxiti për të shkruar këtë shkrim, por respekti për të kujtuar me nderim gjyshin tim, Rapsodin nga kryeqyteti i Alpeve Shqiptare, Thethi, Gjergj Mark Suka, i cili u largua nga kjo jetë plot 40 vite më parë. E kujtoj me nderim për ato virtyte dhe vlera të larta të malësorit që la e trashëgoi ndër ne. Për emrin dhe nderin që i la familjes e krahinës, për të cilat kronikanët e kohës i patën dedikuar edhe një artikull të veçantë, shumë të vlefshëm për ne ku gjej rastin ta nxjerr nga arkiva e familjes e ta bashkëndaj me lexuesit dhe dashamirësit e folklorit mbarë shqiptar.

Rapsodi 105-vjeçar, botim i revistës "Shqipëria Sot", në vitin 1983

E kemi fjalën për lahutarin Gjergj Marku.

Jeton në fshatin Rragam, në zemër të Alpeve shqiptare, skaji më verior i ven-



Rapsodi Gjergj Marku, gusht 1983.



dit tonë. Kjo krahinë përfaqëson një nga zonat më origjinale dhe më madhështore të natyrës sonë. Alpet janë

krahina më malore e Shqipërisë. Ato ngrihen në mënyrë të menjëhershme, duke sajuar forma nga me të bukurat dhe më të çuditshmet, që të japin përshypjen e një kështjelle madhështore shkëmbore.

Janë 48 maja, secila me lartësi më se 2200 metra. Ndërsa majat zbardhojnë nga bora shekullore, luginat gjelbërojnë nga flora e larmishme, ujërat e pastra që formohen nga shkërrja e dëborës, krijojnë me rrjedhën e tyre të vrullshme lumenj të kristaltë dhe përbëjnë një bukuri të rrallë të natyrës.

Në këtë krahinë hasen më shpesh edhe njerëzit më jetëgjatë. Njëri ndër ta është edhe Gjergj Marku. Ai është 105 vjeç. Edhe në këtë moshë nuk e heq nga dora lahutën. Që në moshë fare të re ajo ka qenë bashkëudhëtarja e tij. Tingujt e saj kanë shoqëruar këngët e eposit të kreshnikëve. Këto jehojnë edhe sot në zërin e tij. Njëpër të dëgjojmë emra vendesh ku janë zhvilluar beteja, emra heronjsh, njëpër të ndien jehonën e këtyre maleve të thepisura e të shpateve të bjeshkëve. Në këto bjeshkë jetuan e luftuan kreshniket. Honet e tyre dhanë jehonën e parë të trimërisë së heronjve dhe ky heroizëm gdhend në hekur, në dru në gur. Dhe në këngë... Gjenia e popullit krijoi me këto eposin madhështore të Veriut, që rron e vazhdon të këndohet edhe nga Gjergj Marku.

Në ditët tona, Gjergji është lahutari më i moshuar që e këndon këtë krijim të famshëm me lahutën vet gjashtëdhjetëvjeçare. Gjergj Marku ka rreth 90 vjet që këndon. Ne repertorin e tij të eposit të kreshnikëve bëjnë pjesë afro shtatëdhjetë këngë. Ato janë histori e këtij populli, të cilën brezat e lanë, si në stafetë, me këngë e me lahutë. Ndoshta ato do ti dëgjojmë prej tij edhe në podiumin e Festivalit Folklorik Kombëtar në Gjirokastër. Kur dëgjon tek këndon ky lahutar kaq i moshuar të bëjnë për vete mënyra e tij e interpretimit, zëri i tij karakteristik. Të bën përshypje të veçantë



Familja Suka: Petriti, Alma, Emanuel, Emanuela, Elizabeta dhe Elizio

edhe gjendja e tij e mirë fizike: trupin e mban drejt, kujtesa e tij ruan ngjarje të dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit të kaluar. Ai sheh mirë dhe flet pa pengesa. Artin e vet ua ka mësuar edhe pasardhësve.

Lahutës së tij gjashtëdhjetëvjeçare i bien djali i tij Ndueja, dhe i nipi Doda. Tre breza lahutarësh në një familje! Lavdia e heroizmit të luftëtarëve shekullor vazhdon kështu rrugën e brezave. Bashkë me të në repertorin e tyre jehojnë edhe këngët për jetën e re që gëzon sot populli ynë.

Në këtë përvjetor të 40 të tij isha i obliguar ta riktheja në vëmendje këtë shkrim kushtuar kësaj ikone të folklorit shqiptar nga i cili kujtojmë shpesh atë thënien e tij "DARDHA BIE NËN DARDHË", si një respekt që brezat duhet ta ruajnë në kujtesë me krenari.

Nga Petrit Ndue Suka

◀ një burri me plote fisnikëri.

Toma u bë anëtar i Pajtitimit të Gjaqeve mbarëkombëtar. Punoi me shpirt e me zemër për mbylljen e konflikteve, të ngatërresave dhe pajtimin e gjaqeve në Shqipëri dhe në Kosovë.

Toma nuk i festoi dot festë në shpi, as për festën e Pashkës, as për festën e Shënkollit, vetëm duke u marre me pajtime të konflikteve, ngatërresave e gjaqeve, për një dekadë e gjysmë.

Tomë Zef Fusha nuk kërkoi pare apo oferta të tjera për mbylljen e konflikteve, ngatërresave e gjaqeve, por në çdo kohë, ditën e natën, në shi e në borë, në dimër e në vere, në çdo kohë të ditës e të natës u tregua i pa lodhur.

Toma e ndjente, se po i vjen fundi i kontributit të jetës së tij! Për gjendjen e rende shëndetësore që kishte, dajës së tij, Zef Sokol Vladaj, nga fshati Pecaj i krahinës së Shalës, i cili dhe ky ishte një nder pajtimtarët e përkushtuar, i lenë një letër, që në mes të tjerave i shkruante: "Daja Zef

jam i smur! Vazhdoni punën pa nerpreme, ne çdo vatër, ku ka ngatërresa, konflikte e hasmëri. Pajtoni sa ma shumë. Daje po ti la: Amanet Burrat! Mu ban të fala!"

Tomë Zef Fusha u sëmurë rëndë nga një sëmundje e pa shërueshme dhe pas gjashtë muajsh u nda nga jeta, me 5 tetor 2007.

Tomë Zef Fushës iu bë një përcjellje madhështore, në ceremoninë e të cilit morën pjesë personalitete të pushtetit lokal e qendror pa dallime politike deri dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Prof. Dr. Sali Berisha së bashku me bashkëshorten e tij, Liri Berishën.

Tomë Zefi la emër, la fisnikërinë e një burri dukagjinas me gjitha cilësitë e virtytet e një malësori të patundur në idealet e veta, në traditat e Dukagjinit në shërbim të bashkësisë, të familjeve në nevojë, në konflikte, që nuk do të harrohen kurrë.

Për fisnikërinë e Tomë Zef Fushes, mund të shkruash shumë, por më ka mbete e pashlyer në kujtesën time një ngjarje e muajit shtator 2004:

"Ishim në kongresin e Pajtitimit Mbarëkombëtar, në sallën e Operës e Balletit, që zhvilloj punimet e tij Komiteti i Pajtitimit Mbarëkombëtar, më në krye Gjin Markun. Ishte e ftuar në këtë kongres dhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini", prandaj mora pjesë. Tomë Zef Fusha e Kole Lulash Fiku më patën fut në mes dhe ishim në reshtin e fundit të sallës. Në seancën e pare, ishte prezentë zonja e pare (Vajza e Presidentit Alfred Moisiu) dhe z/Kryeministri Namik Dokle. Në seancën e dytë ata u larguan dhe atëherë çdo pjesëmarrës, që u ngrit të diskutonte, fliste kundër qeverisë, se në këtë kohë në pushtet ishte PS-ja ... Pas pak kohe Toma ngrihet pa marre leje dhe del në foltore dhe thekson: Burra jemi duke diskutua dadhash. Nuk jemi mbledhur për të fol për qeverinë apo Presidentin apo për politike, jemi organizate jo poli-

tike, jo qeveritare e jofitimprurëse, por jemi mbledhur në këtë Kuvend për të diskutua se si kemi punuar e se si duhet të punohet më mirë. Për të folur për prejardhjen tonë, nuk besoj se në këtë Kuvend ka pjesëmarrës me një të kaluam më të renduar, deri në palce, se sa familja e ime..." dhe u largua nga foltorja, e ul në vend. Heshtje varri! Ndryshoi krejt rrjedhja e punimeve të këtij Kuvendi.

Në plotë veprimtari të Shoqatës Atdhetare "Dukagjin" janë ftuar burrat, por kishte nga ata, që nuk donin të merrnin pjesë, për arsye të pakuptimita ..., por Toma ju thoshte: "Duhet të shkojmë se, na kanë thirrur burrat, për Dukagjinin...!"

ëPer veprimtarinë e tij atdhetare e humane është nderuar me "Çmimi i Virtytit".

Ky ishte fisniku dhe miku im, Tomë Zef Fusha. Prandaj, lavdi jetës e veprës së tij, të Tomë Zef Fushës!

Ndue Sanaj e Vuksan Fusha

DEMOKRACIA DHE FAMILJA E PJETËR KUKEL PERPEPAJT



Frrok Vukaj

Historia është një nocion i gjerë; ajo shkruhet e pasurohet pandërprerë, ditë për ditë e vit për vit. E bëjnë njerëzit e po këta e përfytyrojnë. Ajo zë fill tek familja, pa të cilën nuk do të kishte as fe, as atdhe, as histori, as shoqëri.

Për çdo familje ke çfarë shkruan e çfarë publikon, ato janë një pasuri e madhe dhe e paçmuar, si kroatet e bjeshkëve që mbushin dete e oqeanet, që ushqejnë një tokë pjellore, që lëvrohet pa pushim, që prodhon fruta e trashëgon breznit.

Sot do të shkruaj për një familje që nuk është e panjohur, por ka edhe disa veçanti, që e bëjnë edhe më të njohur e të vlerësuar.

-Para 30 vitesh, e mbledhur atje mes malesh e pllajash përralore, në Currajin e Epërm të largët, mbi 1000 metër mbi nivelin e detit, tashmë janë larguar, rritur e shtuar shumë, jetojnë në kryeqytet e kanë marrë rrugët e Evropës e Amerikës.

- Të shquar për harmoni mes tyre e me bashkësinë, për dashurinë e vullnetin për punë të ndershme e për arritje sa më të qëndrueshme; Tirana e Londra janë dy vendbanimet e tyre të përqendruara.

-Mbase jo çdo ditë, por së paku çdo javë, mblidhen, gëzojnë e bisedojnë, shkëmbejnë përvojë, bëjnë bilance e projektojnë për arritje të tjera.

-Mundësitë që ka krijuar demokracia nuk i kanë shpërdoruar, por kanë ditur e dinë t'i përdorin pozitivisht për krijimin e të mirave materiale e shpirtërore.

-Lidhjet e pandërprera me vendlindjen e fryma atdhetare, e ushqyer e kultivuar me kujdes e dashuri edhe tek brezi i ri, që jo vetëm punojnë, por edhe shkollohen e integrohen mirë.

-Modestia e fryma humane, ruajtja e traditave pozitive, e kujtesës për të kaluarën, por me shikimin përpara.

Kukeli i famshëm e i biri, Pjetër Kukeli
Është disa e pa shpjegueshëm plotësisht, se si në Malësitë e Veriut (pa përjashtuar as ato të Jugut) ka pasur burra me mençuri të veçantë, që ruhen brez pas brezi në memorien e popullit. Të paharruar

kanë mbetur emrat e Binak Alisë e Isuf Groshit-Krasniqe e Gash, Nikë Mengjës e Tunxh Miftarit - Mërtur, Deli Sokolit e Kukel Ndue Përpepajt -Nikaj, Mark Lulës e Mark Sadikut - Shalë, Gjon Marashit-Shosh, Martin Gjonit-Toplanë, Lazër Palit-Duzhman e të tjerë.

Krahas këtyre emrave është rreshtuar edhe Kukeli, një figurë e njohur shumë, mençuria e thjeshtësia e të cilit hyjnë në kufijtë e legjendës, duke u cilësuar si "Kukeli i mençëm, Kukeli i gatë, Kukeli i drejtë, Kukeli i famshëm, Kukeli i Currajve e të tjera." i cili ka jetuar deri në vitin 1968.

Kukeli ishte i shquar në Veri e më gjerë, si mendimtar popullor, me një mençuri e pjekuri të veçantë, me gjykime të ndershme e të drejta, me autoritet absolut e respekt të madh nga populli, trashëgimtar i shquar i traditave më të mira e atdhetar i kulluar, organizator e luftëtar i shquar për çështjen kombëtare, i papërkultur e i pathyeshëm ndaj çdo pushtuesi apo diktature, që dhunonte pavarësinë, lirinë e të drejtat e njeriut.

U dallua në luftën kundër ushtrive serbo-malazeze në vitin 1915, më vonë përkrah lëvizjeve përparimtare të viteve 1920-24 të udhëhequra nga Bajram Curri, Luigj Gurakuqi e Hasan Prishtina.

Ai shpesh herë është vënë edhe në shënjestër nga regjimet e kohës, për

min.

Në këto vite Kukeli burgoset, ku njihet edhe me Prekë Calin. Me ndërhyrjen e Gjon Marashit të Shoshit lirohet pas 3 muajsh.

Kur dukej se nuk ka asnjë rrugëdalje, mendja e tij pjellore gjente një shteg me dalë.

Intuita, intelekti e trimëria e tij prej diplomati e psikologu popullor, arriti të shpëtojë shembjen e Kishës së Currajve në vitin 1967 përballë drejtuesve më të lartë të rrethit, të ardhur si bisha me shkatërruar atë objekt kulturi, por edhe me vlera historike, simbolin më domethënës të fshatit e zonës.

Të bësh emër pas një babai shumë të shquar, është disi e vështirë, por, edhe Pjetra, pati një jetë me peripeci e me disa pika kulmore me vlerë:

-Mori pjesë si partizanë afro dy vite, e, pas Çlirimit të vendit, shërbeu për pesë vite të tjera në forcat e Kufirit, kryesisht në Sarandë, madje edhe në detyrën e komandantit të Postës.

-Me ndërhyrjen e të atit, në vitin 1949, largohet nga ushtria; arsyeja për ta martuar.

-Jetoj në Curraj, duke u përballur me shumë vështirësi, por krijoi një emër të mirë në popull, i cili për disa vite i besoi edhe detyrën e sekretarit të Këshillit Popullor.

Deri kur mbylli sytë, u shqua për nder-

unë kam pasur fatin e mirë të punoj në këtë fshat në vitet 1974-75, duke njohur edhe këtë familje nga afër e historitë e mençuritë e njërit prej mendimtarëve më në zë. (Gjetën e kam pasur nxënë në 8-vjeçare Curraj Epër, Skënderin në Shkollën e Mesme Bujqësore e Ndoun kur vazhdoi me korrespondencë po këtë shkollë).

...Krahas shumë të tjerëve, kur punoja në Curraj e më vonë në Shkollën e Mesme, shqueshin edhe dy djem, me energjinë e rinisë e pjekurinë e të moshuarve, për të cilët kam ruajtur e ruaj shumë respekt. Ishin kohë të vështira: fshati 3 orë larg nga qendra e kooperativës e nga qyteti edhe 4 orë të tjera, varfëri e madhe, në një sistem të egër, ku mund të bëheshe viktimë e përjetshme, qoftë edhe me pakujdesi e gjëra absurde.

Djelmoshat për të cilët fillova të flas ishin Ndue e Mhill Përpepajt. Ky i fundit, larguar nga jeta si rezultat i një aksidenti para dy vitesh e një gjysmë. Për cilësitë pozitive, qysh në rini, i besuan e u shqua në drejtimin e punëve në fshat; disa vite i kryen detyrën e Kryetarit të Këshillit Popullor të fshatit Curraj. Emri e kujtimi i të ndjerit, ruhet e do të kujtohet me respekt edhe për shumë vite.

Me Ndue Pjetër, të rrih e të bisedosh, është kënaqësi e ke çfarë mëson prej tij; modestia e sinqeriteti, mençuria e largpamësia, urat e komunikimit, janë disa



Brezi i ri-ruan e përtëritë traditën

mendjen e hollë e racionale, bazuar në trashëgiminë e përvojën e gjatë që krijon historia. Zgjidhjet e tij ishin të mençura e praktike, të kujdesshme e largpamëse, të qëndrueshme e të drejta, ndaj, jo radhë, ka ndodhur që tu dështojnë planet pushtetarëve e të deleguarve, të cilët e respektonin sa për sy e faqe, se ja njihnin edhe aftësitë, por me zemër kishin smirë e urrejtje. "Kokrra", siç thotë populli, ishte diku tjetër, por e luftonin hapur e fshehtas për kushëririn e tij, Kolë Ademi, ish oficer i arratisur me 1950, edhe ky me histori e bëma që nderojnë krahinë e shqiptariz-

shmëri e si punëtor i palodhur, rriti e edukoi me virtytet më të mira, me dashurinë për punën e njerëzit, 9 fëmijë, që e kanë lartësuar traditën e emrin e të parëve.

Jo vetëm po ruajnë me nder emrin e gjyshit e babait, por po e ripërtërijnë e përjetësojnë.

Hapësirat e mundësitë e krijuara pas viteve '90, janë shpërblyer me arritje të konsiderueshme bazuar në mbijetesën e punën e ndershme, përballë një konkurrence të egër, duke krijuar e promovuar vlera materiale e shpirtërore.

Përveç lidhjeve miqësore e shoqërore,

cilësi që bien në sy.

Problemet e tij kanë qenë disi më delikate, për arsye të atyre që kam shkruar më sipër, por, edhe i xhelozisë e konkurrencës, për të frenuar brezin e ri, me cilësi e mendësi më përparimtare se paraardhësit, që gëzonin respektin e popullit. Bumerang ishin "garda e vjetër" e ligjet strikte e absurde të kohës.

Edhe në ato kushte të vështira e jo favorizuese, duhej mbijetuar, duhej ecur përpara, duhej bërë e pa-

◀ treguan emocionet që kanë përjetuar kur Kryetari i Bashkisë së qytetit të Firences, z. Nardella i kishte akorduar z. Lulëzim Vulashi titullin e lartë “Qytetar Nderi” me motivacion nderi dhe respekti për humanizmin e tij të rrallë.

I mahnitur nga arritjet e këtij djaloshi të palodhur, tek shijoja gatimet tradicionale në restorantin e tij, arrita të përjetoja dhe shijoja suksesin e bujarisë së pashoqe të këtij shqiptari zemërmirë që kishte bërë emër në tokë të huaj.

Djaloshi Lulëzim Vulashi cilësohej si një nga shqiptarët më të suksesshëm, i cili me pasionin dhe vullnetin e tij të mirë, kishte arritur majat në fushën e gastronomisë në Itali, ku krahas punës për zhvillimin e biznesit, kishte bërë edhe shumë akte bamirësie deri edhe duke ofruar ushqim falas për shtresat në nevojë, veçanërisht në përudhen e pandemisë.

Si shumë familje shqiptare edhe familja e Lulit ka sakrifikuar gjithçka të investuar ndër vite në Shqipëri dhe është larguar për një jetë dhe të ardhme më të mirë.

Kështu, si shumë të rinj shqiptar, në shtator të vitit 1996 edhe djaloshi adoleshent, Lulëzim Vulashi u bë pjesë e aventurës së rrezikshme të emigrimit, në një kohë shumë të vështirë që përjetonte Shqipëria.

Ky djalosh i burrëruar para kohe, arriti, jo vetëm të ambientohet në tokën italiane, por dhe të krijojë premiset për të tërhequr pranë vetes familjen e tij. Ishte vetëm 16 vjeç, por me guxim dhe vizion për të ardhmen e tij.

Me të ardhur në Firence ky djalosh i apasionuar pas arkitekturës, ëndërronte të vazhdonte studimet e larta në këtë degë, duke qenë se edhe vetë qyteti i Firences shquhej për vlerat e tij.

Me gjithë përpjekjet dhe dëshirën për ta realizuar këtë ëndërr të tijën, kushtet ekonomike dhe vështirësitë sociale nuk ia mundësuan, prandaj u detyrua të fillojë punë. Tradita italiane e gastronomisë që ngrinte në pedestal binomin “Pane e vino”, me të cilën u dashurua edhe Luli nga Shkodra, e nxiti atë drejt një sipërmarrje të madhe që konkludoi me hapjen e një restoranti dhe një furrë buke njëkohësisht.

Suksesi të pasuron xhepin, por shpirtin ta pasuron bujaria, thoshte Luli një fjalë të urtë, tek shpjegonte se si e ndjente kënaqësinë shpirtërore nga bekimet e njerëzve në nevojë, që ushqeheshin nga bujaria e zemrës së tij.

Është vërtetë kosto të dhurosh bukë falas, shprehej Luli kur e pyesnin, por kjo është më e pakta që mund të bëjë për këtë vend e këta njerëz që më pritën krahehapur, sepse këtu u mbusha me shpresë, ku gjeta punën. Ky vend më siguroi të ardhmen, thotë ai me mirënjohje.

Fillimisht kur hapëm dyqanin, shumica e miqve të mi ishin në krizë të thellë ekonomike aq sa shpreheshin se kishin frikë të bëheshin me fëmijë. Frikësisë tyre Luli iu përgjigjej “Janë kohë të vështira vëllezër, ndaj bëni fëmijë se bukën do ua jap unë”.

Kjo gjendje u bë shpresëdhënëse, sidomos për emigrantët shqiptarë, por edhe për italianët e thjeshtë që ishin nevojtarë.

Kjo ishte arsyeja, tha Luli, që më shty-



ri të jepja sa munda nga vetja për bashkëvëllezërit e mi e jo vetëm, se ashtu si ne, kishte plot emigrantë të kombësive të tjera, por edhe vendas.

Fillimisht nga të ardhurat e biznesit ofruam ndihmë për nënat shtatzëna, familjet me fëmijë deri gjashtë muajsh



dhe ato më në nevojë, pastaj sa më shumë rritej biznesi aq më shumë zgjerohej mundësia për tu dhënë ndihmë edhe të tjerëve.

Ajo që Lulit i ka dhënë forcë në gjithë këto vite në “Pane Amore Fantazia” ka qenë puna e tij për prodhimin e atyre produkteve, por që ka arritur të kthehet në një shkollë që ta bëjë krenar dhe t’i thotë Botës se edhe ne jemi të mirë në këtë fushë.

Një shqiptar model nga i cili mund të krenohemi të gjithë ku siç thoshte Nënë Tereza, “Ne nuk mund të bëjmë gjëra të mëdha, por gjëra të vogla me dashuri të madhe” dhe unë pa frikë mund të them se Lulëzim Vulashi është shembulli i gjallë i kësaj fjale të urtë.

Ky biznesmen që çdo gjë e ka arritur me një vullnet e pasion të jashtëzakonshëm, ka edhe momente që me respekt kujton edhe ngjarje të veçanta ku e ndjen veten të nderuar dhe të respektuar.

Ai kujton me respekt ish Kryeministrin Renci, një florentin i thekur, i cili vinte në “Pane Amore Fantazia”, shijonte prodhi-

met, madje për këtë ka shkruar edhe një letër përgëzimi për arritjet dhe sukseset e Lulit.

Ky lokal është i vogël, por me zemër të madhe. Është në një nga rrugët më të bukura të Firences dhe një pikë e rëndësishme referimi për shqiptarët që mbledhen aty dhe që janë të pasionuar për gatimet shqiptare dhe italiane, të cilat: “E kush i bën më mirë se Luli”.

Luli është i lidhur shumë me Shqipërinë, sepse para se të bëhej i njohur me “Pane Amore Fantazia”, ishte ndër të parët që organizonte koncerte me këngëtarë shqiptarë që i sillte në Itali. Kënga e bukur shqiptare kishte aromën e bukës sonë tradicionale që Lulëzim Vulashi jo vetëm e prodhonte, por edhe e bekonte me zemrën e tij të bardhë.

U largova i mrekulluar me besimin se njerëz të tillë na mbushin me optimizëm për ta merituar emrin e denjë “SHQIPTAR”!

Ramazan Çeka,
Firence - Itali, Janar 2023

